

20240170409

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË MBROJTJES SË FËMIJËVE

Neni 1

Në Ligjin e Mbrojtjes së Fëmijëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18, 198/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut numër 104/19, 146/19, 275/19, 311/20, 294/21, 150/22 dhe 236/22), në nenin 78, në paragrafin (4) fjalët “Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë” zëvendësohen me fjalët “Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative, Procedurë të Marrëdhënies së Punës dhe Mbikëqyrje Inspektuese në Shkallë të Dytë”.

Neni 2

Në nenin 87, paragrafi (4) fjalët: “Ministria e Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalën “ministra”.

Neni 3

Në nenin 88, në paragrafin (3), në nenin 90 në paragrafin (4), në nenin 102, në paragrafin (5), në nenin 123, në paragrafin (14) dhe në nenin 125 në paragrafin (6) fjalët “Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë” zëvendësohen me fjalët “Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative, Procedurë të Marrëdhënies së Punës dhe Mbikëqyrje Inspektuese në Shkallë të Dytë”.

Neni 4

Në nenin 143, në paragrafin (12) dhe (18), fjalët “Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë” zëvendësohen me fjalët “Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative, Procedurë të Marrëdhënies së Punës dhe Mbikëqyrje Inspektuese në Shkallë të Dytë”.

Në paragrafin (20) fjalët: “ministri i Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalën “ministri”.

Në paragrafin (21) fjalët: “Ministria e Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalën “ministra”.

Neni 5

Në nenin 156-b, në paragrafin (5), nenin 156 në paragrafin (11) dhe në nenin 156-gj, në paragrafin (4) fjalët: “Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë” zëvendësohen me fjalët “Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative, Procedurë të Marrëdhënies së Punës dhe Mbikëqyrje Inspektuese në Shkallë të Dytë”.

Neni 6

Në nenin 165, paragrafi (6) fjalët: “Ministria e Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalën “ministra”.

Neni 7

Në nenin 166-b, paragrafi (2) dhe në nenin 166-z fjalët: “ministri i Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalën “ministri”.

Neni 8

Në nenin 176, fjalët “Ministria e Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët “Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë”.

Neni 9

Në nenin 177, në paragrafin (3) fjalët “Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurën Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë” zëvendësohen me fjalët “Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative, Procedurë të Marrëdhënies së Punës dhe Mbikëqyrje Inspektuese në Shkallë të Dytë”.

Paragrafi (4) ndryshon si vijon:

“Licenca e punës është dokument publik dhe lëshohet në dy kopje, nga të cilat njëra kopje është për parashtruesin e kërkesës, ndërsa kopja tjetër mbetet në Ministri. Licenca lëshohet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, dhe nëse parashtruesi i kërkesës flet gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me kërkesë të tij e njëjta i lëshohet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën që e flet dhe alfabetin e saj”.

Neni 10

Në nenin 177-b, paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“Pjesa e parë e provimit nga paragrafi (1) i këtij neni, jepet në mënyrë elektronike duke iu përgjigjur një numri të caktuar pyetjesh me zgjidhjen e testit elektronik në kompjuter, në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, dhe nëse kandidati flet gjuhën që flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me kërkesë të tij, i mundësohet ta jep provimin në gjuhën që e flet dhe alfabetin e saj.”.

Pas paragrafit (3) shtohen dy paragrafë të rinj (4) dhe (5) si vijojnë:

“(4) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, në rast kur sistemi i vetëm elektronik për dhënien e provimit profesional për marrjen e licencës për punë nuk është në funksion, ndërsa për shkak të urgjencës së skajshme që mos ketë ngecje në kryerjen e vazhdueshme të procesit të licencimit, pjesa e parë e provimit nga paragrafi (1) i këtij neni, do të jepet në formë të shkruar, në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, ndërsa nëse kandidati e flet gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me kërkesë të tij i mundësohet ta jep edhe në gjuhën që e flet dhe alfabetin e saj.

(5) Mënyrën e dhënies së provimit nga paragrafët (2) dhe (4) të këtij neni, e përcakton ministri.”.

Neni 11

Në nenin 177-g, paragrafi (8) fjalët “dhe administrativ” shlyhen, ndërsa fjalët “ministri i punës dhe politikës sociale” zëvendësohen me fjalën “ministri”.

Paragrafi (9) ndryshon si vijon:

“Për punët administrative-teknike të Komisionit nga paragrafi (1) i këtij neni dhe për zbatimin e provimit profesional për marrjen e licencës së punës, ministri cakton më së shumti tre persona administrativë, nga radhët e të punësuarve të ministrisë.”.

“Pas paragrafit (9) shtohet paragraf i ri (10) si vijon:

(10) Personat administrativë nga paragrafi (9) i këtij neni marrin kompensim në të holla për çdo sesion provimi të mbajtur në shumë prej një të tretës së pagës mesatare neto në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për të cilën ministri miraton aktvendim.”.

Neni 12

Në nenin 177-d në paragrafin (3), nenin 177-gj paragrafët (4) dhe (8) dhe në nenin 177-e fjalët: “Ministria e Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalën “ministra”.

Neni 13

Në nenin 177-j, paragrafi (7) fjalët: “ministri i Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalën: “ministri”.

Në paragrafin (8) fjalët: “Ministria e Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalën “ministra”.

Neni 14

Në nenin 195-a, në paragrafin (5) fjalët: “Ministria e Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalën “ministra”.

Neni 15

Në nenin 198, në paragrafin (2) fjalët “Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë” zëvendësohen me fjalët “Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative, Procedurë të Marrëdhënies së Punës dhe Mbikëqyrje Inspektuese në Shkallë të Dytë”.

Neni 16

Në nenin 203, paragrafi (1) fjalët: “Ministria e Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalën “ministra”.

Neni 17

Në nenin 217, paragrafi (1) dhe në nenin 219 paragrafi (2) fjalët “Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë” zëvendësohen me fjalët “Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative, Procedurë të Marrëdhënies së Punës dhe Mbikëqyrje Inspektuese në Shkallë të Dytë”.

Neni 18

Në paragrafin 230-zh fjalët: “ministri i Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalën “ministri”.

Neni 19

Dispozitat e nenit 10 të këtij ligji, të cilat plotësojnë nenin 177-b me paragrafin e ri (4), do të zbatohen deri më 1 janar 2026.

Neni 20

Akti nënligjor i paraparë me këtë ligj do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 21

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktojë tekst të konsoliduar të Ligjit të Mbrojtjes së Fëmijëve.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.